



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS

NOTER ALBANA H. HOTI  
ADRESA NR.4, EGNATIA, NR.405  
TEL: 692059686

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1507

Nr. koleksioni: 826

Durres më 29/07/2022



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022011500092855549

\*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI  
( TË SHOQËRISË "SMARTAK" SH.P.K)**

Sot, më datë 29.07.2022, para meje Notere ALBANA H. HOTI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durrës, NR.4, EGNATIA, NR.405, u paraqit personalisht:

**SHITES:**

**Letizia Calosso**, atësia Bernardino, amësia Luciana, shtetase Italiane, lindur në Vigevano dhe banuese në Vigevano, me adresë Valle San Martino Nr. 34 Vigevano, Itali, lindur më 12/09/1996, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Kod Fiskal Nr. CLSLFZ96P52L872E dhe nr. personal AY7691304, ortake e vetme me 1 kuote, përqindja në kapital ne **100.00%**, me kontributi në para **625.000,00 (ALL) (GJASHTEQINDE E NJEZETE K PESEMIJE LEKE)**, ne shoqerine "SMARTAK" SH.P.K me NIPT L82030002F, te cilet ne kete kontrate do te cilesohet **si pala shitese**.

**BLERES:**

**Shpresa Sagajeva**, atësia Gani, amësia Nurie, shtetase Shqiptare, lindur në Cakran, Fier dhe banuese në Durrës, me adresë Rajoni 5 Rr.Hazizshkupi; Nd. 0; Durrës; Durrës; 2007; Durrës, lindur më 01/04/1978, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjofitim ID nr. 036634217 dhe nr. personal H85401203J, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "SMARTAK" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

**Kushte te pergjithshme:**

Shoqeria "SMARTAK" SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Regjistrin Tregtar date 30/08/2018, me NIPT L82030002F, me seli në DURRES LAGJEN NR.15, Spitalle, Objekt sherbimesh 2 kat+Garazhd, me NR.Pasurie 104/14, ZK 8517, vol 12 faqe 215, me aktivitet në fushën Ushtrim aktiviteti nën regjimin e perpunimit aktiv. Projektimin, prodhimin dhe tregtimin e kepuceve, sholleve dhe aksesoreve për kepuce, projektimin dhe prodhimin e modeleve dhe stampave për kepuce, perpunimi me te trete i kepuceve dhe komponenteve për kepuce, dizajn, marketing dhe dhenien me qira të impianteve, makinerive dhe pajisje për prodhimin e kepuce dhe pjesëve të kepuceve në gome termoplastik, poliuretani dhe materiale të tjera plastike, projektimin dhe tregtimin e aksesoreve për veshjet dhe kepuçet. Fasoneri. Kompania mund të kryejë çdo aktivitet tjetër që nuk është parashikuar në këtë objekt aktiviteti gjithnjë të rregulluar sipas ligji-lacionit shqiptar. Kompania mund të kryejë të gjitha operacionet e pasurive të patundshme, të tundshme dhe financiare që do të vlerësohen nga ana e organit administrativ të nevojshme ose të dobishme për të përmbushur objektin e shoqërisë. Ajo mund të japë hua dhe çdo garanci tjetër, për detyrimet e marra nga palët e treta, pavarësisht nga objekti apo vlera etj. Ushtrimi i çdo lloji veprimtarie të lejueshme nga ligji për person juridik dhe për formën juridike të shoqërisë, sipas përcaktimeve të Ekstraktit të regjistrit tregtarë leshuar nga Qkrja, ku Ortak-ja e saj është dhe pala shitesë **Letizia Calosso** me ortake e vetme me 1 kuote, përqindja në kapital ne **100.00%**, me kontributi në para **625.000,00 (ALL) (GJASHTEQINDE E NJEZETE E PESEMIJE LEKE)**, ne shoqerine "SMARTAK" SH.P.K me NIPT L82030002F.

Palët kanë rënë dakord paraprakisht për kalimin e titullit të pronësive mbi kuotën dhe kapitalin e shoqërisë sipas përcaktimeve që do të behen në këtë Akt shit-blerje, për masën dhe mënyrën e kalimit të kuotave Pales Blerese.



A2022011500092855549

Per sa me sipër dhe bazuar edhe ne nenin 73, te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008, "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, nga ligji nr. 129/2014, "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9901, date 14.04.2008, "Per tregtarët dhe shoqerite te ndryshuar", palet bien dakord si me poshte vijon:

#### ***Neni 1-BLERJA E KUOTAVE NE SHITJE***

Sipas kushteve dhe afateve te kesaj Kontrate, ne Daten e nenshkrimit te saj, Pala Shitese i shet Pales Blerese dhe Pala Blerese do te bleje nga Pala Shitese, Ortak me 1 Kuote, **Përqindja në kapital ne 100,00%, me Kontributi në para 625.000,00** qe ka ne pronesi e shoqerise sipas menyres se percaktuar me poshte:

Shitesia **Letizia Calosso**, do t'i shesi Blereses dhe Bleresia Shpresa Sagajeva do te bleje 1 (nje) kuote, **Përqindja në kapital ne 100,00 %, me Kontributi në para 625.000,00**, nga Shitesia i kuotes, te kapitalit te shoqerise dhe çdo te drejte qe lidhet me to, te lira nga cdo Barre, me çmimin e blerjes dhe te pagueshme sipas menyres qe percaktohet po aty.

#### ***NENI 2-ÇMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESES***

Çmimi total i blerjes se kuotes se kapilati eshte **8,000.00 euro (euro)**, shume e cila do te transferohet nepermjet transfertave bankare nga pala blerese ne llogarine e pales shitese. Pas nenshkrimit te kesaj kontrate nga palet, pagimit teresisht te çmimit nga ana e bleresit vertetuar kjo nga mandati bankar, kjo kontrate regjistrohhet prane QKB, Tatim Taksave per te bere te mundur kalimin e pronesise se tyre ne favor te pales blerese.

#### ***NENI 3-DEKLARIMET DHE GARANCITE***

Pala Shitese me ane te kesaj Kontrate deklarone dhe garantone ne lidhje me Shoqerine si dhe me transakcionin qe parashikohet ne kete Kontrate.

Pala Shitese deklarone dhe garantone se shoqeria eshte krijuar dhe themeluar sipas ligjeve shqiptare, nuk eshte ne gjendje paafesi paguese apo ne falimentim.

Pala Shitese deklarone se jane ndjekur rregullish, te gjitha aktet ligjore dhe /ose procedurat e tjera te parashikuara nga legjislacioni shqiptar qe duhet te ndermeren nga ose per llogari te Shitesit dhe qe autorizojne Shitesin te lidhe dhe te zbatoje kete kontrate.

#### ***NENI 4-PRONESIA***

Pala Shitese eshte pronar i vetem dhe i ligjshem i gjithe kuotave qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise.

Kuotat ne shitje jane te lira nga cdo Barre e cfaredo lloji dhe Shitesja ka te gjitha te drejtat, kompetencen dhe autorizimin e plote per ti shitur, per t'i kaluar apo ransferuar dhe dorezuar kuotat ne shitje ne perputhje me afatet e Kontrates.

Nuk ka asnje Kontrate, marreveshje apo detyrim qe krijon apo vendos barre ne lidhje me kuotat ne shitje ose ndonje numer kuotash te autorizuar por te paemtuara ne kapitalin e Shoqerise. Asnje person nuk pretendon se ka te drejte mbi ndonje barre te mundshme te lidhur, me kuotat qe jane ne shitje.

#### ***NENI 5-MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE***

Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, pala shitese e humbet te drejten e pronesise mbi 1 kuote, **Përqindja në kapital ne 100,00%, me Kontributi në para 625.000,00.**

Ortaku i Shoqerise **Letizia Calosso**, humbet pronesine ne masen 1 kuote, **Përqindja në kapital ne 100,00%, me Kontributi në para 625.000,00**, te Kapitalin themeltar te shoqerise "SMARTAK" SHPK, duke kaluar te drejten e pronesise Bleresit si ortake e vetme Shpresa Sagajeva.

#### ***NENI 6-PREMTIME TE PERBASHKETA TE PALEVE***

Palet do ti sigurojne njera-tjetres, cdo dhe gjithe informacionin e nevojshem per perfundimin e ketij procesi.

#### ***NENI 7-LIGJI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI***

7.1 Kjo kontrate rregullohet nga ligji shqiptar.

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;

Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";



A2022011500092855549

Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

7.2 Te gjitha mos marreveshjet qe mund te lindin ndermjet palve ne lidhje me kete Kontrate do te zgjidhen me mirekuptim, ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e e rrethit Gjyqesor Durres.

### ***NENI 8-TE NDRYSHME***

#### ***8.1 Ndryshimet***

Çdo korigjim, ndryshim , zgjidhje apo heqje dore nga ndonje prej dispozitave te kesaj Kontrate, do te jete e vlefshme vetem ne qofte se behet me shkrim dhe nenshkruhet nga ose per llogari te seciles Pale.

#### ***8.2 Vlefshmeria e pavarur nga njera tjetra e dispozitave kontraktore***

Ne rast se nje dispozite ose detyrim sipas kesaj Kontrate eshte i pavlefshem, i paligjishem ose i pazbatueshem ne nje juridksion, vlefshmeria ligjshmeria dhe zbatueshmeria e dispozitave ose detyrimeve te tjera , ose e ketyre detyrimeve ne nje juridiksion tjetër, nuk do te preket ose cenohet nga nje fakt i tille.

Palet pranojne se do te perpiqen te zevendesojne nje dispozite te pavlefshme ose te pazbatueshme ne masen me te madhe te mundshme, per te permbushur qellimin e kesaj dispozite.

#### ***8.3 Njoftimet***

Njoftimet ose komunikime te tjera sipas ose ne lidhje me kete Kontrate (Njoftimi) do te jene:

- Me shkrim
- Ne gjuhen shqipe
- Do te dorezohen ose dergohen me poste te shpejte me kthim pergjigje ose faks, pales qe duhet te marre njoftimin ne adresen e caktuar nga pala perkatese.

Me perjashtim te rastit kur provohet se njoftimi eshte marre me shpejt, njoftimi do quhet i dhene nese:

- Eshte derguar me poste , 10 dite pune , pas postimit te tij
- Eshte derguar me faks , kur konfirmimi i dergimit te tij eshte regjistruar nga faksi i derguesit.

#### ***8.4. Kalimi i te drejtave***

Kjo Kontrate eshte detyrim ligjor dhe ne perfitim te paleve , trashegimtareve te tyre dhe personave te cileve u kalojne keto te drejta.

Bleresi ka detyrimin ligjor te regjistrimit te kesaj kontrate brenda 30 diteve nga dita e nenskrimit te saj prane QKB-se, si dhe njoftimin e administratorit ne lidhje me kete transakcion.

#### ***8.5. Kostot dhe taksat***

Pervec kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, secila pale do te paguaje shpenzimet e saj ne lidhje me negocimin, hartimin, nenshkrimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate dhe te shtojcave te saj (nese do kete). Te gjitha shpenzimet noteriale per nenshkrimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate do te paguhen nga Pala Blerese.

#### ***8.6. Teresia e Kontrates***

Kjo Kontrate perben marreveshjen e plote dhe zevendeson cdo marreveshje te meparshme midis paleve qe lidhet me objektin e kesaj Kontrate.

### ***NENI 9-ANEKSET E KONTRATËS***

9.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneks të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me nr.1, datë 28.07.2022;
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "SMARTAK" Sh.p.k.. datë 28.08.2018;
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Faturë e transfertës bankare të Credins Bank sh.a.;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

### ***10-DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE***



A2022011500092855549

10.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; Per palen shitese shtetase italiane iu lexua ne gjuhen italiane nga perkthyesja zyrtare e Ministrise se Drejtesise, Znj. Iris Dhamo e bija e Vladimir, lindur me 07/09/1989, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033989910 dhe nr. personal I95907056L.

Palët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

10.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

10.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

### PALËT KONTRAKTUESE

#### SHITES

Letizia Calosso

#### BLERES

Shpresa Sagajeva

#### PERKTHYES LIGJOR

Iris Dhamo



Notere

ALBANA H. HOTI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS  
NOTER ALBANA H. HOTI**



**DATE 30/07/2022  
NR REP 1511**

**VËRTETIM PËRKTHIMI**

Vertetoj nënshkrimin e përkthyesit Znj Iris Dhama, e bija e Vladimir, lindur më 07/09/1989, në Durrës dhe banuese në DURRËS, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim nr. 033989910 dhe Nr. Personal I95907056L, përthyes i licensuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila deklaroi se perktheu njësoj me origjinalin dokumentin bashkalidhur "Kontrate Shitje Pasuri e luajtshme", nga gjuha Shqipe në gjuhën Italiane . Unë, noterja, duke gjetur këtë akt në përputhje me ligjin, e vërtetoj atë, në bazë të nenit 135 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

**NOTERE  
ALBANA H.HOTI**



REPUBBLICA DI ALBANIA  
CONSIGLIO NAZIONALE DEL NOTARIATO  
CONSIGLIO NOTARILE DI DURRËS

**AUTENTICA DI TRADUZIONE**

Autentico la firma del traduttore Sig.ra Iris Dhama, figlia di Vladimir, nata il 07/09/1989, a Durrës e residente a DURRËS, maggiorenne con piena capacità giuridica di agire, identificata per mezzo della carta d'identità nr. 033989910 e del Nr. Personale I95907056L, traduttore giurato, licenziato dal Ministero della Giustizia, la quale dichiara di aver tradotto, conforme all'originale, l'allegato documento "Contratto di vendita delle Quote del capitale ", dalla lingua albanese in lingua italiana . Io, notaio, considerato il presente atto conforme alla legge, lo autentico ai sensi dell'art. 135 della Legge nr. 110, del 20.12.2018 "Sul Notariato".

**NOTAIO  
ALBANA H. HOTI  
Sigla/timbro**

Shoqëria "SMARTAK" SH.P.K.

NIPT L82030002F

seli ne DURRES LAGJEN NR.15, Spitalle , Objekt sherbimesh 2 kat+Garazhd, me NR.Pasurie 104/14, ZK 8517, vol 12 faqe 215

## VENDIM I ORTAKUT TË VETËM

Nr. \_\_\_\_\_, dt. 28.07.2022

Shoqëria e regjistruar në Regjistrin Tregtar me dt.30/08/2017 me objekt në fushën fushen Ushtrim aktiviteti nen regjimin e perpunimit aktiv. Projektimin, prodhimin dhe tregtimin e kepuceve, sholleve dhe aksesoreve per kepuce, projektimin dhe prodhimin e modeleve dhe stampave per kepuce, perpunimi me te trete i kepuceve dhe komponenteve per kepuce, dizajn, marketing dhe dhenien me qira te impianteve, makinerive dhe pajisje per prodhimin e kepuce dhe pjeseve te kepuceve ne gome termoplastik, poliuretani dhe materiale te tjera plastike, projektimin dhe tregtimin e aksesoreve per veshjet dhe kepuce. Fasoneri. Kompania mund te kryeje çdo aktivitet tjeter qe nuk eshte parashikuar ne kete objekt aktiviteti gjithnje te rregulluar sipas ligjislacionit shqiptar. Kompania mund te kryeje te gjitha operacionet e pasurive te patundshme, te tundshme dhe financiare qe do te vleresohen nga ana e organit administrativ te nevojshme ose te dobishme per te permbushur objektin e shoqerise. Ajo mund te jape hua dhe çdo garanci tjeter, per detyrimet e marra nga palel e treta, pavaresisht nga objekti apo vlera etj., ME KAPITAL NE PARA 625,000.00 LEK.

Ortaku i vetëm i shoqërisë **Letizia Calosso**, e mbledhur sot më dt.28.07.2022 në selinë e saj mori vendimin si më poshtë vijon:

1. Ortaku i vetëm **Letizia Calosso**, vendosi t'i shese kuoten e kapitalit :1 kuote, përqindja në kapital ne **100.00%**, me kontributi në para **625.000,00 (ALL) (gjashtëqinde e njetete e pesemije leke)**, me vleren 8,000.00 (euro), shtetases Shpresa Sagajeva.
2. Ngarkohen punonjësit e shoqërisë "SMARTAK" sh.p.k. të kryejnë veprimet konform vendimit të marrë për depozimin e vendimit në regjistrin e vendimeve të shoqërisë dhe depozitimin e vendimit në QKB.

Ortaku i vetëm

V E N D I M

I ORTAKUT TE SHOQERISE " SMARTAK " sh.p.k

Ne Durrës, sot me datën 29.07.2022, në ambientet e Selisë së Shoqërisë, nën thirrjen e Administratorit, mbahet mbledhja e shoqërisë.

Është prezent Ortaku:

**1. Shpresa Sagajeva**, zotëues i kuotes 100% të kapitalit

Mbledhjen e kryeson ortaku Znj. **Shpresa Sagajeva**  
Ortaku e deklaroi mbledhjen të hapur me këtë;

Rend Dite: 1. Ndryshimi i Administratorit.

Fillon shqyrtimi i problemeve të Rendit të ditës...

Flet Ortaku Shpresa Sagajeva, i cili thotë :

Lidhur me çështjen Rend Dite;

Administratorit në detyrë nuk do të jetë me në rolin e administratorit në subjekt. Për këtë arsye mbledhet asambleja e ortakut të shoqërisë për emerimin e administratorit të ri. Une propozoj shkarkimin e Administratorit Z.Luigi Bernardo Calosso dhe emerimin e administratorit të ri të jetë Znj. Shpresa Sagajeva dhe afati i emerimit të jetë për periudhën 29 Korrik 2022 deri 29 Korrik 2027.

Si përfundim, Ortaku i Shoqërisë,

**V E N D O S I :**

1. Të shkarkohet administratori i shoqërisë Z. Luigi Bernardo Calosso.
2. Të emerojë si administrator të shoqërisë Znj. Shpresa Sagajeva.
3. Afati i mandatit të administratorit të jetë 29 Korrik 2022 deri 29 Korrik 2027
4. Të depozitohet ky Vendim i asamblese pranë "QKB" nga Znj. Shpresa Sagajeva me kartë identiteti Nr. personal H85401203J.

Me pas mbledhja e Shoqërisë deklarohet e mbyllur.

O R T A K U

( )